




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

N J O F T I M

Duke u bazuar në nenin 17 dhe në zbatim të nenit 18 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të datës 06.11.2014, në zbatim të nenit 4 të Rregullores për Transparencë në Komunë dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2013 për Transparencë në Komunë, njoftohen zyrtarët, qytetarët, shoqatat, grupet e interesit dhe bartësit e institucioneve të komunës dhe anëtarët e Kuvendit të Komunës, se me datën **13.10.2021 (e Mërkurë)** do të mbahet dëgjimi publik prej orës **11:00** në sallën e Kuvendit të Komunës së Gjilanit ish ndërtesa e Gjykatës, do të mbahet:

DËGJIM PUBLIK PËR

1. PROJEKTI: PARTNERITETI PUBLIKO PRIVAT (PPP) PËR “PËRMIRËSIMI I EFIKASITETIT TË NDRIÇIMIT PUBLIK NË KOMUNËN E GJILANIT” dhe

Diskutimet publike kanë për qëllim të ofrojnë informata në lidhje me draft projektin PPP për “Përmirësimin e efikasitetit të ndriçimit publik në Komunën e Gjilanit”, të përgatitur nga ekspertë të jashtëm, ndërsa bartëse është Komuna e Gjilanit, respektivisht Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Drejtoria për Shërbime Publike Banim dhe Infrastrukturë dhe për të marrë opinione, sugjerime dhe komente të justifikuara për projektin në fjalë nga zyrtarë, përfaqësues të sektorit privat, ekspertë, qytetarët dhe grupet e interesit (OJQ-të etj) dhe të tjerë për të finalizuar dhe siguruar cilësi të lartë të komponentëve të projektit me interes të përgjithshëm publik.

Ju inkurajojmë për pjesëmarrje duke respektuar rekomandimet e IKSHP dhe vlerësojmë lartë kontributin tuaj në këtë dëgjim publik i cili është i një rëndësie të veçantë për komunën e Gjilanit.

Ju mirëpresim!

Gjilan, 28.09.2021

Komuna e Gjilanit